

25341/9

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TIRANË
 Nr. 25341/___9___

VENDIM I GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 22 tetor 2003, unë, *[Signature]*, gjyqtare pranë kësaj gjykate, pasi studjova kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga z. James Reiff në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë PARTNERI SHQIPTAR NË MIKROKREDI SHA për depozitimin e akteve të personit juridik,

KONSTATOVA SE:

Shoqëria anonime PARTNERI SHQIPTAR NË MIKROKREDI SHA është person juridik i së drejtës shqiptare, regjistruar me Vendimin Nr. 25341, datë 2 mars 2001 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me seli në adresën Rruga "Gjin Bue Shpata", Nr. 7/1, Tiranë dhe me aksionerë: 1) shoqërinë Opportunity Microcredit Fund (Eastern Europe), shoqëri e krijuar në bazë të ligjeve të Anglisë dhe Uellsit, e themeluar më 24 Shkurt 1998 me Numër regjistri 3516266; dhe 2) shoqërinë Opportunity Transformation Investments Inc. shoqëri e krijuar në bazë të ligjeve të Illinois, e themeluar më 19 Qershor 2000.

Më datë 9 Janar 2003 është zhvilluar mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të shoqërisë PARTNERI SHQIPTAR NE MIKROKREDI SHA, e cila ka vendosur:

1. Të miratojë futjen në shoqërinë PARTNERI SHQIPTAR NE MIKROKREDI SHA të aksionerit të ri Fondacioni Shqiptar i Misionit Menonit (Albanian Mennonite Mission Foundation), një fondacion shqiptar, i organizuar në bazë të ligjeve shqiptare, themeluar më 16 Prill 2002, me Vendimin nr. 39, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, duke blerë aksione në rritjen e kapitalit.
2. Të zmadhojë kapitalin aksioner të shoqërisë PARTNERI SHQIPTAR NE MIKROKREDI SHA duke emetuar 678 aksione të reja me vlerë nominale Lekë 10,000 (dhjetë mijë) secili. Zmadhimi i kapitalit me shumën Lekë 6,783,000 (gjashtë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë), do të bëhet si më poshtë:
 Opportunity Microcredit Fund (Eastern Europe) heq dorë nga pjesëmarrja në zmadhimin e kapitalit aksioner;
 Opportunity Transformation Investments Inc. do të nënshkruajë 468 aksione të reja që i korrespondojnë shumës Lekë 4,683,000 (katër milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre mijë);
 Fondacioni Shqiptar i Misionit Menonit do të nënshkruajë 210 aksione të reja që i korrespondojnë shumës Lekë 2,100,000 (dy milion e njëqind mijë).
 Duke blerë aksionet si më sipër, struktura e aksionerëve të shoqërisë PARTNERI SHQIPTAR NE MIKROKREDI SHA do të jetë si më poshtë:
 - Opportunity Microcredit Fund (Eastern Europe) zotëron 19,258 aksione që i korrespondojnë 45,89 për qind të kapitalit aksioner;
 - Opportunity Transformation Investments Inc. zotëron 22,490 aksione që i korrespondojnë 53,61 për qind të kapitalit aksioner;
 - Fondacioni Shqiptar i Misionit Menonit zotëron 210 aksione që i korrespondojnë 0,5 për qind të kapitalit aksioner;
3. Pas zmadhimit, shuma totale e kapitalit aksioner të shoqërisë PARTNERI SHQIPTAR NE MIKROKREDI SHA është Lekë 419,583,920 (katërqind e nëntëmbëdhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e njëzetë).

Më datë 8 tetor 2002 është zhvilluar mbledhja e Bordit të Drejtorëve të Fondacionit Shqiptar i Misionit Menonit i cili ka miratuar futjen si aksioner të këtij Fondacioni në shoqërinë PARTNERI SHQIPTAR

NE MIKROKREDI SHA. Më datë 20 shkurt 2003 është lidhur Kontrata e Shitjes së Aksioneve midis Fondacionit Shqiptar i Misionit Menonit dhe shoqërisë PARTNERI SHQIPTAR NE MIKROKREDI SHA.

PËR KËTO ARSYE:

Pas shqyrtimit të kërkesës, e çmoj atë të mbështetur në ligjin Nr. 7638, 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjin Nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare",

VENDOSA:

- Pranimin e Kërkesës;
- Depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të shoqërisë PARTNERI SHQIPTAR NE MIKROKREDI SHA të datës 9 Janar 2003 për: 1) futjen në shoqëri të aksionerit të ri Fondacioni Shqiptar i Misionit Menonit (Albanian Mennonite Mission Foundation), një fondacion shqiptar, i organizuar në bazë të ligjeve shqiptare, themeluar më 16 Prill 2002, me Vendimin nr. 39, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, duke blerë aksione në rritjen e kapitalit; dhe 2) zmadhimin e kapitalit aksioner të shoqërisë PARTNERI SHQIPTAR NE MIKROKREDI SHA me shumën Lekë 6,783,000 (gjashtë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë), duke emetuar 678 aksione të reja me vlerë nominale Lekë 10,000 (dhjetë mijë) secili. Pas zmadhimit struktura e aksioneve të shoqërisë është si më poshtë:
 - Opportunity Microcredit Fund (Eastern Europe) zotëron 19,258 aksione që i korrespondojnë 45,89 për qind të kapitalit aksioner;
 - Opportunity Transformation Investments Inc. zotëron 22,490 aksione që i korrespondojnë 53,61 për qind të kapitalit aksioner;
 - Fondacioni Shqiptar i Misionit Menonit zotëron 210 aksione që i korrespondojnë 0,5 për qind të kapitalit aksioner;
- Shuma totale e kapitalit aksioner të shoqërisë PARTNERI SHQIPTAR NE MIKROKREDI SHA është Lekë 419,583,920 (katëqind e nëntëmbëdhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e njëzetë) lekë.
- Depozitimin e Vendimit datë 8 tetor 2002 të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit Shqiptar i Misionit Menonit, të Kontratës së Shitjes së Aksioneve date 20 shkurt 2003, midis Fondacionit Shqiptar i Misionit Menonit dhe shoqërisë PARTNERI SHQIPTAR NE MIKROKREDI SHA dhe të certifikatës bankare për shlyerjen e rritjes së kapitalit.
- Urdhërohet zyra e Regjistrat Tregtar të bëjë pasqyrimin e ndryshimeve në skedën përkatëse të shoqërisë.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit.

GJYQTARE

